
RECENSIONE

FERIT DUKA: “SHEKUJT OSMANË NË HAPËSIRËN SHQIPTARE (STUDIME DHE DOKUMENTE)”, UET Press, **Tiranë 2009, 465 f.**

Çdo libër/studim në fushë të studimeve osmane është më shumë se i mirëpritur, pasi kjo periudhë e historisë shqiptare për vetë shtrirjen dhe problematikën që ngërthen është padyshim, më e rëndësishmja për të shpjeguar, jo vetëm historinë moderne dhe realitetin e sotëm shqiptar, por edhe më gjerë atë ballkanik.

Një aspekt tjetër që e bën këtë libër të mirëpritur në studimet shqiptare dhe ato osmane në përgjithësi është fakti se, ai përfshin një gamë tejet të gjerë dokumentacioni historik, që vjen nga kancelari të ndryshme, shfrytëzimi në dorë të parë të të cilave, kërkon një përgatitje të posaçme filologjike.

Osmanisti Ferit Duka i përket gjeneratës së dytë të studiuesve osmanistë shqiptarë. Në vitet '80 u specializua pranë Universitetit të Ankarasë dhe të Stambollit (Turqi) dhe falë pasionit dhe natyrës së tij sistematike, ai sot është përfaqësuesi më i denjë i gjeneratës së tij.

Vepra që sot kemi në dorë, është fryt i viteve të tëra pune në këtë fushë të vështirë studimi. Pjesë të konsiderueshme të saj na janë paraqitur kohë pas kohe në trajtë artikujsh dhe studimesh, porse tani ajo vjen si një tekst i plotë literature historike e periudhës osmane të historisë së Shqipërisë. Ndaj, kjo vepër na e lehtëson shumë punën për të mbërritur tek idetë dhe pikëpamjet e tija shkencore, por nga ana tjetër, nëpërmjet këtij botimi, kemi rastin të njihemi me ecurinë e mendimit historik dhe të thellimit të përvojës profesionale të këtij autori ndër vite.

Larmia e temave të trajtuara dëshmon më së miri se autori, përtej preferencave individuale, ka rrokur probleme me shumë peshë për historishkrimin e kësaj periudhe të rëndësishme të historisë sonë. Studimet e përfshira në këtë libër përbëjnë kontribute tejet të rëndësishme për jetën urbane (f. 94-131; 149-219; 335-372), problemet etnike të shqiptarëve në Ballkan (f. 105-130; 131-148; 149-168; 219-246), por dhe për rolin që feja në përgjithësi dhe ajo islame në veçanti kanë luajtur në jetën e shqiptarëve (41-72; 73-81; 82-94).

Historiani Ferit Duka ka trajtuar si fatin historik të grupeve etnike jo shqiptare brenda kufijve të territorit politik shqiptar, si ai i hebrenjve, ashtu edhe historinë e viseve të Çamërisë dhe Maqedonisë Perëndimore, që sot nuk gjenden brenda kufijve politikë të shtetit shqiptar. Ai, më së shumti, ka trajtuar tema të historisë sociale, etnike dhe fetare, duke hedhur dritë mbi disa aspekte që historiografia profesionale shqiptare e periudhës komuniste nuk i trajtoi për

arsye ideologjike, por edhe për faktin se, ajo u përpoq, më së shumti, të ndërtonte një histori politike të Shqipërisë. Ky aspekt i librit të Ferit Dukës sjell një risi në studimet shqiptare për periudhën osmane.

Prof. Duka ka meritën se, është ndër të paktët studiues profesionistë shqiptarë që problematikën e shekujve osmanë në viset shqiptare e sheh nga brenda, mbi bazën e dokumentacionit sistematik e të plotë osman, çka këtij libri i jep sa origjinalitet aq edhe mendim solid dhe të qëndrueshëm. Njohja e gjuhës osmane dhe e disa gjuhëve perëndimore i jep dorë autorit të ndërtojë një tablo të qartë për subjektin tematik që shkruan.

Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare shënon një arritje si në aspektin e gamës së gjerë të temave që janë trajtuar në të, ashtu edhe në faktin se ajo sot është dëshmia më përfaqësuese e ecures së studimeve osmane, sidomos, pas viteve '90, por edhe të nivelit në të cilin ndodhen sot studimet osmane në Shqipëri. Në këtë kontekst, ky libër ofron një panoramë të realitet osman në viset shqiptare, por që në të njëjtën kohë përbën një pjesë të rëndësishme të mozaikut ballkanik të kohës osmane.

Ky libër shënon një arritje të rëndësishme jo vetëm në karrierën profesionale të prof. Ferit Dukës, por edhe një arritje të rëndësishme të osmanistikës shqiptare, çka autorin e legjitimon plotësisht si një personalitet të spikatur në këtë fushë sa të rëndësishme aq edhe të vështirë studimi.

Dritan EGRO